

BIBLIOTEKA

88H-1  
E 45

Nexhip  
Ejupi

# PESHA E DUARVE



*vjersha  
dhe  
poema*

88H-1  
E 45

Nexhip  
Ejupi

**PESHA  
E DUARVE**

*vjersha  
dhe  
poema*

43413

12413

## MONOLOGU I AGRONOMIT

Jam diku në mes të fushës së pamatë,  
Miku i përhershëm i hapësirave me blerim,  
Kallinjtë në lartësinë e shpatullave të mia,  
Seç thonë për mua ca fjalë pa pushim.

E di kuptimin e fëshfërítjes së grurit,  
Që më ndjek sonte hap pas hapi në arë,  
Ajo më skaliti bashkë me tiparet e burrit,  
Krenarinë dhe shqetësimin e përditshëm në ballë.

Kjo fëshfërimë, e gjëzueshme vjen që poshtë fushës,  
Që thellë tokës, ku flenë ëndërrat e stërgjyshërvë të  
mi,  
Është gjuha shumë e lashtë dhe shumë e re e bukës,  
Që flet me fëshfërimën e këtij gruri të ri.

N I S J E      T U M O R O W I A G R O N O M I

Kokat e vogëlushëve të kërrusura janë  
Mbi fletoret me vija, mbi bukurshkrim,  
Mësuesja përkulet nga banga në bangë,  
Në sy e në ballë seç ka një shqetësim.

I shkruar me shkumës shqetësimi zbardh,  
Po duhet hedhur në fletoret me vija,  
Germat, dorëpërdore si vogëlushët në radhë,  
Kapen me merakun e penës në gishta.

Fleta me vija po mbushet pak nga pak,  
(Shqetësimi i mësueses kalon tek ata),  
Alfabeti i diturisë zë fill nga ky merak,  
Universiteti çel udhën që nga shkronja «A».

## PJEKURIA DHE FËMIJËRIA

U rritëm, shok, u bëmë burra,  
Tani në flokë na dalin thinja,  
Në ballë mendimet gdhendin rrudha,  
Me to nái gdhëndet pjekuria.

Po prapëseprapë me këmbëngulje,  
Jo si mohim për pjekurinë,  
Në shpirt diku na çelin lule,  
Kujtimet për fëmijërinë.

Të mos kish sythe në fillim,  
S'do kishte frute kurrë më vonë,  
E lidhur rri me pjekurinë  
Kjo moshë e sytheve të njomë.

## GJASHTË DITË

Janë gjashtë ditë në jetën time, gjashtë,  
Që më bënë me plot gojën njeri,  
Jo se në ato ditë u bëraq së pari baba,  
Porse rroka së pari fshesën në shtëpi.

Atë fshesë nuk ia shkova vetëm shtëpisë,  
Ndjeva së ajo fshesë po më pastronte dhe mua,  
Ato gjashtë ditë më bënë amvisë,  
Në kohën që ti bëheshe nënë, grua...

## **N G R O H T E S I**

Ngrohtësi nuk jep vetëm druri kur digjet,  
Apo nafta, qymyri, që i gjejmë në thellësi,  
Dëgjo shokun tënd që e pyet e të përgjigjet,  
A nuk ndien të çlirohet prej fjalëve ngrohtësi?

## T'I SHTYPIM NË VEZË

Pësh-pësh... Pësh-pësh...  
E more vesh?  
Pësh-pësh... Pësh-pësh...  
S'e mora vesh...

— Mos i ke veshët  
Zënë me pambukë?  
— Po ti moj korbë,  
A ke ngrënë bukë?

Pa qasu pranë,  
Ta them në vesh,  
Pësh-pësh... Pësh-pësh...  
Kujdes... Kujdes...

— E di mirë ti? *është e mirë*  
— E di mirë, pra. *është e mirë*.  
Vërtet? Hi-hi! *është e mirë*.  
Vërtet! Ha-ha! *është e mirë*.

Po ti, lexues; *çfarë po i di*  
A more gjë vesh; *çfarë po i di*  
Nga kjo gjarpërítje; *çfarë po i di*  
Prej gojës në vesh? *çfarë po i di*

Mes gojës dhe veshit  
Megafoni i dorës,  
Në vrimë të veshit  
Hyn helmi i gojës.

— Ish shef i mirë,  
Por, ah, ç'e do...  
Qyqja, ky tjetri!  
Bubu!...Bobo!...

— E pe Selvinë?  
S'e mendoja kurrë!  
Shyqyr që gjeti  
Një copë burrë!

Nga bota e vjetër  
Në ditët tonë  
Enden ca shpirtra,  
Ca hije, kufoma...;

Pësh-pësh... Sytë katër  
T'i bëjmë kudo,  
T'i shtypim në vezë,  
Përndryshe ato...

Shqipëri i ri i përfundon  
Me një dëgjimi i madh  
Dhe qëndron me rast  
Ditën e parë e vitit.

Ditën e parë e vitit  
Dhe qëndron me rast  
Ditën e parë e vitit.

## ERA

C'qe kjo erë që fryu, që rrëzoi shaminë,  
Si flutur të bardhë fushës fluturim?

Renda për ta kapur në një shteg të blertë  
Ah, kjo erë e malit... Ah, kjo erë e rreptë...

Shtegut një çapkën c'ma kish zënë pusinë,  
Si t'ia bëja, mënë, t'ia merria shaminë?

As shaminë s'ia mora, as djalit s'i ika,  
Prita të më fliste, të më fliste prita...

Fryu erë e malit... Mori mendtë e mia...  
Ah, kjo erë qënka vetë dashuria...

## NË VJESHTË

A. S. S.

Vjeshta cdo gjethe e zverdhi në drurë,  
Për udhë i rreshtoi patat e egra,  
Kujtimet e nënës s'trishtohen më kurrë,  
Kur nisen patat në vendet e nxehtha.

Kuqës është gjë që shtrirët e na marrin,

Jashtë e është gjë që dëshironi që do t'ju bëj.

Ka kohë që iu shëruan plagët e kurbetit,  
Patat mërgojnë pa trishtimin e nënës,  
Me bijtë dhe bijat në arat e vjeshtës,  
Lumturia e madhe zuri vendin e dhembjes.

Mërguan përsëri patat krahëlehta  
Atje ku mërgonin kurbetçinjtë dikur,  
Po nënës sime plot me nipër e mbesa  
Rrudhat në ballë s'do t'i trishtohen më kurrë.

1. M. D. L. A. N. G. E.  
2. M. D. L. A. N. G. E.

1. M. D. L. A. N. G. E.  
**PESHA E DUARVE**

poemë

Eh, ky vendi ëm;  
Nuk i ka kursyer  
Legjendat për malet  
Dhe këngët për fisin;  
Nëpër gryka malesh,  
Sa gryka dyfekësh,  
Mes erës së dimrit  
Gjëmonin e krisnin!

Ngaqë e desh hekuriñ,  
Po aq sa lirinë,  
Për të ai u vra  
E u pre në shekuj;  
Në betejë e sipër  
Ndezi fantazinë,

Pranë gjakut lindi  
Legjendat me hekur.

Populli që njohu  
Robëri të rëndë,  
Populli që çau  
Histori të gjatë,  
Vallë si ta bënte  
Qoftë dhe një këngë,  
Për çelik e hekur,  
Ashtu, duarthatë?

Ç'kishte tokë jonë  
Poshtë në thellësi?  
Gjyshërit i flinin  
Në gji tokës mëmë;  
Ndërsa sipër tyre  
Kish pagjumësi,  
Rendin troke kuajsh,  
Derdhej gjak e gjëmë.

Posa varte armën,  
Sa kërrusej mbi kudhër,  
Në derë hyntë thirrja:

— Hej, u premë në besë!  
Dhe brofte drejt saj,  
Me gjithë malet rrrotull,  
Dhe kthehej prej saj,  
Me gjithë malet peshë.

Ftohej prapë furra,  
Nxihej prapë qomyri,  
Balli i mjeshtrit çuhej  
Nga rrudhat përmës:  
— Nga erdhi kjo gjëmë?  
— E keqja si hýri?  
— Deri kur unë shkrirjen  
Do ta lë në mes?

Ne që edhe ditën  
Na kanosej nata,  
Ramë për këto troje,  
Ramë për këtë prak;  
Mundëm që të shkrinim  
Metal sa për shpata,  
Duke shtrydhur djersë,  
Duke shtrydhur gjak.

Se ky prak na rriti  
Trima luftetarë,  
Famën na e goi  
Gjer përtëj atdheut;  
Kur binim për të,  
Çelte përmbi varr  
Amaneti i gjakut,  
Që s'e trette dheu.  
  
Shpirti ynë i dliërë,  
Kovachana blozë,  
Rreziiku tek dera, —  
Ne asgjë ndër duar...  
C'mund t'i bënim, pra,  
Ashtu, duarbosh,  
Katilit që fisin  
Erdh për të na shuar?

Po në dej seç kishim  
Një flakë që s'na shuhej,  
Një prush që ditë-natë  
I ndezur na rrinte,  
Me prush e me flakë  
Urrejtja gatuhej,  
Tek palë e flamurit  
Gjaku flakërinte.

Zjarri ndizej brenda  
Gjoksit tē çdo mjeshtri,  
Prandaji çdo gjoks kishte  
Përngjasim me strallin,  
Ballë pēr bällë armiqves  
Me urejtjen shkrepnint  
Zjarrin e pērbrendshém,  
Që brenda s'ed imbanin.

Mjeshterinëae babës  
Mésonte fëmija,  
Vatrën ta clironte iold  
Nga thonjtë e vëtmisë,  
Që epikët'i kishte  
Tingujt çiftelia,  
Të mos shuhej kurrë  
Zjarri i lirisë.

E dinimi se hekur  
Kishte tokannënë,  
Po me se ta onxirrnim  
Që nga thellësitë?  
Zgjedhë e robërisë  
Ç'ishte aq e rëndë,  
Kohën ç'na e hanin  
Luftrat me armiqtë!

Halle kishim shumë,  
Ç'të qanim më parë! . . .  
Nga ky fat greminë  
Dhe malet vajtonin. . .  
Hallet përmbi vete  
I mbartnim si barrë,  
Pa ditur as vetë,  
Se ku t'i shkarkonim.

Sa luftra përsipër,  
Aq tmerre duroi,  
I bloi të gjitha  
Si mokër në heshtje,  
Nëntoka e shurdhër,  
Nëntoka pa gojë  
As mundi të fliste,  
As mundi të qeshte. . .

Të huajt lakmonin,  
Që të zhvatnin copa,  
Thela nga kjo tokë,  
Të ndanin në mes,  
Por, tek ngulnin dhëmbët,  
Seç rënkonte toka,  
Bijtë, të alarmuar,  
Bënin besa-besë.

Vërtet, fisi im  
S'ka qënë kurrë i qetë,  
Përmes shqetësimit  
Ai çau rrugë;  
Zgjodhi dru në pyll,  
Me të bëri djep;  
Zgjodhi dru në pyll,  
Për të bërë lahutë!

Melodi krijoi  
Edhe me një gjethë,  
Edhe në një këngë  
Qau hall me malet,  
Trimërinë e rriti  
Me ninulla djepi,  
Me dogra i vuri  
Në shinjestër krajlet.

Lindur në rrëthim,  
Rritur në rrëthim,  
Pëllëmbë për pëllëmbë  
Derdhëm gjak e djersë,  
Nga të huajt, gjak  
S'lypëm asnë grimë,  
Nga të huajt s'deshëm  
Asnjë bulëz djerse.

Ç'bluante atdheu  
Nën füqinë e mbretit,  
Tek i thyente mesin  
Peshë e monarkisë?  
Malet e tij nisin  
Bijtë drejt kurbetit,  
Mallin pfej mërgimit  
Mbanin mbi kurri.

Ai s'ishte mbret  
Po ishte kusari  
Shqipérinë e shiti  
Si çifligjet e tij  
Gjaku i saj mbretit  
I kthehej në ar  
Popullit ky është  
I kthehej në zi.

Fort na dhimbë zemra,  
Thellë na dhimbë shpirtë  
Kur të huajt vidhën  
Edhe një grusht dhë  
Na therri një gjithë kockat,  
Na therritë gjithë mishin,  
Ishte pjesë e jötja,  
Dhimbja jone, atdheu.

Nëntoka kish ethe  
Si në agoni,  
Minerali rrinte,  
Diku thellë, fjetur,  
Kush do ta zgjonte,  
Nga kjo letargji,  
Ta bënte të fliste,  
Ta bënte të geshur?

Nën krisma naganti,  
Nën krisma belxhiku,  
Natë e robër isë,  
Mori plagë pér vdekje;  
Këto krisma ishin  
Flakë metalurgjiku,  
Këto krisma kishin  
Prush e flakë jetë.

Kur do vinte koha  
Të prodhonim hekur,  
Koha që ta ishkrinim  
Mineralin vetë?  
Ky ish padurimi  
Që pati edo shekull,  
Vetëm koha jonë  
Atij i dha jetë.

U ngul kazma e parë,  
U vu guri i parë...  
Jo, kjo ditë kurre  
S'do të ketë harrim,  
Për një çast dhe dielli  
Ndaloj për të parë  
Gjithë atë hare,  
Gjithë atë gëzim...

Cep më cep të fushës  
Gruri mugullonte,  
Shpërtente së brendshmi  
Gjoksi i blerimit;  
Që përposh përsipër  
Hodhën shtat e gonxhe  
Lulet e pranverës  
Në mbarim të dimrit.

Ç'ishin këto lule,  
Që çelën kaq shpejt?  
Ato te kjo fushë  
I mbolli vetëjeta,  
Erdhi socializmi  
Si një stinë e pestë,  
Dhe u mbush kjo fushë  
Me lulet piketa!

Pastaj erdhi vera  
Me grurin e pjekur,  
Me grurin e fundit  
Që s'do mbillej më...  
Me një tjetër farë,  
Me farëm e hekurt,  
Do të mbillej fusha  
Tani përgjithnjë.

Net saldatriçesh,  
Net ferrobotoni,  
Ndiqnin njëra-tjetrën  
Nga turni në turn;  
Këtu betonohej  
Vetë revolucioni,  
Ritej pylli i hekurt  
Fushës së pagjumë.

Tani trenat zbresin  
Drejt metalurgjikut  
Si legjendë e re  
Përmes Shqipërisë,  
Vjen nga lashtësia  
Legjendë e çelikut,  
Te nëntokë e moçme  
Gjithnjë do pijë sisë.

Në një tunel hyn,  
Në një tjetër del,  
Sirena e trenit,  
Zëri i mineralit;  
Vagonat ngarkuar  
Me hekurnikel  
Natë e ditë gjëmojnë  
Nëpër bark të malit.

Nëntoka memece  
Seç u bë me zë,  
S'ka më bëlbëzim,  
S'ka më shurdhërin,  
Udhët e mbitokës  
U futën nën të,  
Zemra e ngirë  
Nën dielloshkri.

Nis e fllet legjenda,  
Nis e fllet nëntoka,  
Me net diellore  
Nëpër galeri;  
Duke situr vite,  
Shekuj dhe epoka,  
Zërin e nëndheshëm  
S'e ndrydhëmë në gjë!

Tani ti, moj botë, (1)  
Ta kesh vëth në vesh,  
S'jemi ne ai brezi, (2)  
Që përdorte pishë, (3)  
Që liri e hekur (4)  
Nëpër mote i desh, (5)  
Që liri e hekur (6)  
Nëpër mote s'kish. (7)

S'jemi më ai brezi, (8)  
Që thyhej në arë, (9)  
Që i jepte beut (10)  
Të tretën e djersës, (11)  
Që te koka kishte (12)  
Milicë e xhandarë, (13)  
Që i pinin gjakun, (14)  
Që i pinin jetën. (15)

Dhe pati të huaj (16)  
Që si «miq» na erdhën, (17)  
Që u qanë: — Të varfér  
E paski nëntokën! (18)  
Po ne ua premë (19)  
Gjuhën e nëpërkës, (20)  
Dhe pas mineralit (21)  
Ua thyem kokëp! (22)

Qenë «specialistë»  
Me dy palë harta,  
Në hartën sekrete  
Shënonin çdo gjë,  
E kryqet i ngulnin  
Në malet e larta,  
E në hartën tonë  
S'shënonin asgjë.

Lakmuani aq tepër  
Që t'u thonim «peqe»,  
Ne që s'i thamë «peqe»  
Shekujve asnjerit,  
Ne që s'na ra ndryshku  
Kurrë mbi dyfeqe,  
Që bëmë flurudhë plumbi  
Flurudhën e zërit.

C'realitet i hekurt  
Që është kombinati,  
Pa shih se ç'korpuse,  
Pa shih ç'lartësira!...  
Një nga një në fushë  
Zunë vend furrnaltat,  
Sikur zunë vend  
Gjithë projekt-dëshirat.

E shkuli shqiptari  
Mllefin shekullor,  
Krenar i thotë botës:  
— Ja çeliku im!  
Gëzimin e ndien  
Gjer në palcë të kockës,  
Një mal minerali  
Në një orë e shkrin!

Kjo është krenaria  
Që përshkon gjithë kohrat,  
Nga brezat që shkuan  
Tek brezat që vijnë;  
Vitet dhanë shekuj,  
Shekujt dhanë epoka,  
Brezat luftëtarë  
Bashkë dhanë lirinë!

Kjo është vepra jonë,  
E gjakut, e djersës.  
Kjo është krenaria  
E rrugës së gjatë,  
Nisur nga parmenda,  
Deri te traktori,  
Që nga kovaçhana,  
Te ky KOMBINAT!

— Nga tregimet e babait —

## COPËZA JETE . . .

— Nga tregimet e babait —

### 1 - Uria

Im atë ngistëspendën e qeve, më  
Im më nga pas hidhët e farë,  
Dielli i fshehur i prapa rive, më  
Hidhte hije të zezë në arë.

Kërrusesha në brazdën e misrit,  
Shpejt e shpejt me farëza mbushja xhepin,  
Më merrej fryma prej nxitimit,  
Të mos haja dackat e tim eti.

I fshehur pas gärdhit, në heshtje  
Dëgjova babanë në arë:  
— Moj grua, a je në vete,  
Ç'ke bërë kështu më farën?!

Në shtëpi i thashë atit tim  
Se fajin e kisha unë vetë,  
Unë, që, për të shuañ ûrinë,  
Përtypja farëzat «vjedhura» në xhep.

**2 - Vëllai**

Kam pasur një vëlla të sëmurë,  
Kam pasur një vëlla me të nxehë,  
Me nënën e çuam mbi mushkë  
Te hoxha, te vendi i shenjtë.

Nëna i jepte prapë gjigë  
Megjithëse ai ishte motak,  
Hënëza e fytyrës së tij  
Po shuhej dalëngadale, pak riga pak.

Hoxhës në tyrben e madhe  
I dëgjova tri herë «allah»,  
Pastaj tri herë me radhë  
Nomatisi me buzë një duva.

I dhamë një okë me lesh,  
Një okë me gjalpë i dhamë,  
Kur ikëm, tri herë pas nesh  
Hoxha përsërithi duvanë.

Po ç'ndodhi me vëllanë në shtëpi?  
Ah, ç'dhimbjë që kam për këtë!  
Kur nëna e vuri në gji,  
Ai s'deshi të pijë kurrë më!...

### **3 - Pishat**

Mes shkëmbinjve përballë erës  
Në mal rriten drunjë e pishës,  
Këta drurë halorë të vegjël  
Ne i quanim drurë të dritës.

Pishat rrënjet futnin thellë,  
Që prej malit mblidhnin flakë,  
Prisnim ashkla degë më degë  
Dhe i lidhnik në vandakë.

Dhe kujtonim ne, fëmijët,  
Se veç pisha ndrit në botë,  
Se asgjë përveç pishës,  
S'jepte dritë aq të fortë.

Kështu ikën ato vite,  
Kur i vogël unë isha,  
Duke mbledhur ashkla drite  
Nëpër pyjet plot me pisha.

#### 4. Kaziu

Në fshat seç erdhën befasishëm,  
Njëri në gjermanisht seç klithi,  
Sytë e kaut nga unë lëvizën,  
Kur ballisti erdhi e ma zgjidhi.

Dhe dita m'u bë! natë e errët,  
Pse s'e kisha maliherin pas krahut;  
Që të mos pëndoheshë herë tjetër,  
U desh pushkatimi i kaut.

Nuk e di se pse më kurxyen;  
Tek zgëdhiheshin si ujqëri në arë,  
Si dukej, nga kënaqësia që më shqyen  
Zemrën time, edhe pa më vrarë.

## 5. Revolta

— Mjaft më! — i fola prerë vetes,—  
O bujk, që arë nuk pate kurrë,  
Njeri je ti, o i biri i Metes,  
Njeri që i ropën shtatë lëkurë.

Dhe dora rröku maliherin,  
Dhe malin mora në furtunë,  
Dhe beu s'ma harroi emrin,  
Dhe emrin s'ia harrova unë.

E lashë parmendën' mu në arë,  
E thonë që beu shumë u nxeh,  
E thonë që beu mori zjarr;  
E thonë që beu bëri be.

Teksá më ndiqte ditë e natë  
Me millef tē egér si tē ujkut,  
Një malihet më krismë tē thatë,  
Tregoi ç'mund tē bëntë bujku.

Kam hequr shumë, o biri im,  
Kaçak i malit shkrep më shkrep,  
Gjersa u njoha me Partinë,  
Gjersa në ballë një yll m'u qep.

6..**Partia**

Më kishin thënë se Partia ecte zbathur,  
Bashkë me bijtë mes borës, stuhisë,  
Prandaj porosita gruan që gorape  
Të thurte për Partinë dhe për bijtë e Partisë.

Më kishin thënë se rrinte e pangrënë,  
Se bukën e përcillte edhe me një qepë,  
Prandaj i thashë gruaç, brumin e zënë  
Ta gatuante ta piqte në çerep.

Partisë që luftonte zbathur, e pavesur,  
Më kishin thënë që i duheshin shumë pushkë,  
Prandaj pastrova malipherin e fshehur,  
Rrëmbyer armiqve të vjetër në luftë.

Dhe takova në mal një çetë me partizanë  
Dhe i pyeta shtruar, gjatë e gjërë, për Partinë,  
Dhe ata të gjithë një përgjigje më dhanë,  
Dhe unë të gjithëve u zgjata kutinë.

Drodhën partizanët duhan kaçaku të fortë  
Dhe unë ia ndeza secilit vetë me eshkë,  
Dhe u binda atëherë se Partia ishte kudo  
Dhe u njoha me të në mënyrën më të thjeshtë.

1. 19. 19. 19. 19. 19. 19. 19. 19. 19.

## DASMA'E SKËNDERBEUT

1. 1. 1. 1. 1. 1. 1. 1. 1. 1.

Qeshu, nënë e thinjur, po martohet biri,  
Mbi kullë të kështjellës lajmin po jep bëri.

2. 2. 2. 2. 2. 2. 2. 2. 2. 2.

Hipur përbëi kuaj, krushqit po vijnë radhë,  
Nuse vjen Donika me duvak të bardhë.

3. 3. 3. 3. 3. 3. 3. 3. 3. 3.

Krushqit morën plágë, plagët s'janë shëruar,  
Shpatat mbajnë me vete, hipur përbëi kuaj.

4. 4. 4. 4. 4. 4. 4. 4. 4. 4.

2.

Sikur pér betejë briri t'i thérresë,  
Krushqit luftëtarë dasmën lënë në mes.

Dhëndëri vetë do çohej: — Mjaft tani, lahutë,  
Në një dasëm tjetër po na pëftojnë kruhq!

Sikur nxjerr rrufe, shpatën do të nxirrte,  
Nga dasma në luftë trimat do t'i printe!

3. Dhëndëri vjen me një qytetarë që i ka dhënë

3. Dhëndëri vjen me një qytetarë që i ka dhënë

Udhë e largët kuajt i ka lodhur shumë,  
Ç'po këndojojnë dasmorët, sytë nuk duan gjumë.

Si gonxhe hareje lulëzojnë vallet,  
Nga kopshtet e mollëve era sjell petalët.

Dhëndëri nuk fle sonte, as shpata në mill,  
Nuse erdh Donika si lule në prill...

Shpata, shpata, shpata,  
Shpata, shpata, shpata,  
Shpata, shpata, shpata.

SHPATA  
**GJIN BUE SHPATA**  
SHPATA, SHPATA, SHPATA.

Turqit erdhën valë-valë,  
Trimat hop në kalë me shalë,  
Mal u dolën ballë për ballë.

Morën ushta, morën shpata,  
Pa fitore s'bënин prapa,  
Posi shegë pikonte plaga.

Gjin Bue Shpata hapte shtigje,  
Linte pas të vrarët pirgje,  
Gjaku i tyre gërryente brigje.

Me dy shpata duart zënë,  
Frerin kapur fort me dhëmbë,  
Mes armiqve bënte gjëmë.

Mali i Gjérë shpatë e ushtë,  
Përkrat Gjinit-burrat grusht,  
Ndizte zemrat gjaku i prushtë.

Emri i trimit me tri fjalë,  
Çau kohrat lart në kalë,  
Me dy shpata u bëri ballë.

Herë pas here si kushtrim  
Do të shfaqej emri Gjin,  
Rrokjeshkurtëri vetëtimë.

Shekujt seç i çamë me shpatë,  
Duke ngrënë me ta inat,  
Gjithsecili — Gjin Bue Shpatë!

## ÇELËN SYTHE E LULE MOLLËT...

Çelën sythe e lule mollët,  
Dukej se kish rënë dëborë,  
Aq shumë mollë kishin çelur  
Në kopshtijet rrëth e rrrotull.  
Me pranverën erdhi lajmi,  
Lajmi më i zi se korbi,  
Se në brigjet arbërore  
Ishte sulur vetë sultani  
Me njëqind e ca tabore.

Bashkë me kalin, harkun, ushtat,  
Bashkë me shpatën vetëtimë,  
Trokëllimthi u nis trimi,  
Ku e thirri trimëria...  
— Unë do kthehem, — i tha nënës,—  
Një mëngjesi me fitore,

Ja, si ky mëngjes i sotëm,  
Bashkë të vjelim kokrra molle.

Tri ditë nëna s'hëngri gjë,  
Tri net nëna s'bëri gjumë,  
Në të katërtën ditë lajmi  
Fort i hidhur qe për të...  
Po s'vajtoi, s'shkuli flokët  
Dhe nuk i përgjaku faqet,  
Sa e madhe ishte dhimbja,  
Ia tregonin thinjat, rrudhat...

— Trim që solle këtë lajm,  
Më të ëmbël se të hidhur,  
Thuamë, ku e mori plagë,  
Ç'amani të fundit la?  
Luftëtari i tregoi  
Si tri herë ia lidhi plagët  
Porse gjaku prapë kulloi,  
Aq të çara ato ishin...

(Buzët i dridheshin aq shumë,  
Sa s'iu drodhën kurrë në luftra,  
Para nënës që kish rritur

Shokun, që i vdiq në duar).

— Nënë e dhembshur, — fliste trimi, —  
Unë ia mora hakun djalit,  
Që e pate dritë të syrit,  
Që e pata krah të djathtë...

### TURKISH SONGS

Gjaku i tij u bë flamur  
Më rrjedh mua nëpër dej,  
Pra, yt bir tanis jam unë,  
Nismë, nënë, në betejë.  
Dorë e tij me dorën time  
Do shtrëngojë këtë shpatë,  
Krahu i tij me krahun tim  
Koka turqish do presë prapë!

## A R B È R E S H È T

Si jehonë e legjendave pa numër tē ikjes,  
Vjen troku i largët i karvaneve muhaxhire,  
Nëpër natë gjëmon deti në brigjet e vendlindjes,  
Toka nënë zgjat gadishujt pas galerave ilire.

Nata e ndarjes dallgëzon në çdo zemër,  
Nata e fundit e bën detin më tē zi,  
Kush pret, kush pret, matanë, në bregun tjetër?  
Askush nga arbërit nuk e di, nuk e di...

Ç'të marrin me vete? Atdheu është i rëndë.  
Ç'të marrin me vete? Atdheu nuk lëviz...  
Qytetet turku ua bëri gërmadhë e gjëmë,  
Në rrëzë tē gërmadhave karvani i tyre u nis.

Do të ikin, po në botë ka vetëm një Arbëri,  
Nga ajo s'harrojnë një grusht dhé pa marrë,  
Një grusht legjendash e këngësh si nënshtetësi,  
Kur gjysëmhëna ngrihet nëpër natë mbi Ak-

-Hisar.

### THYERI DHE KËNGËSH NË MALLI

Që të mos vdisnin nga malli i madh  
Për atdheun, që nga vendi kurrrë nuk lëviz,  
Trojet e reja kur i ngritën matanë,  
I ngritën ballë për ballë Arbërisë.

Arif Dërralla

Allo, allo, ßig pëtior, më d'la e t'zë, më d'la  
më d'la, q' s'f'zë, d'la, m' t'zë, m' t'zë, m' t'zë,  
d'la, d'la, le ceñonst'e d'la, d'la, d'la, d'la, d'la,  
d'la, d'la, d'la, d'la, d'la, d'la, d'la, d'la, d'la, d'la.

## BIEN DAULLE RRËZE MALIT

Bi en d'li m' egg z'hëibz kon m' d'li  
et'zë! pëtior **Baladë** —  
Bi en d'li m' egg z'hëibz kon m' d'li  
et'zë! pëtior **Baladë** —  
1.

Bien daulle  
Rrëzë malit,  
Rri, Sokol,  
Mos i hip kalit.

Të ka nëna  
Dritë në sy,  
Të ka motra  
Vetëm ty.

Dasma jote  
Po gjëmon,

Gjaksi s'dihet,  
Ku përgjon.

Një tytë pret  
Të nxjerrë flakë,  
Të pret ty,  
të dalësh pak.

Në grazhd kali  
Hingëllin,  
Fton t'i hipësh  
Përmbi shpinë.

## 2.

Krismë tē thatë  
Tyta nxjerr,  
Krismë kobi  
Nëpér terr.

Krisma gjëmë  
Dasmës ra  
Dhe daullja  
Oh, u çä!...

Medet, dhëndëri  
Ra i vrarë,  
Pushoi këngën  
Gjeli i parë.

Dora sipër  
Në lahitë,  
Në çast telin  
E këput.

Dasma shtang  
Dhe gjaku ngrin;  
Kali i trembur  
Hingëllin...

3.

— Nënë, u dogja,  
Moj, prej mallit,  
Sa t'i hipja  
Pakëz kalit.

Vinte nusja,  
Vinin krushq,  
Rrëzë malit  
Plot me dushk.

Si gëzim  
Deshë të zbraz  
Hutën time  
Atë çast.

Gjoksi, ah,  
Flakë m'u mbush,  
Plumb mes meje,  
Plumb mes jush...

Hesht daullja  
Rrëzë malit,  
Natë e dasmës —  
Natë e vajit...

## N E V A D A

O tokë e vdekur nga shpërthimet,  
O tokë e vrarë, o shkretëtirë,  
Veç me kërpudha atomike  
Ke kohë që mbillesh pa mëshirë!

O tokë pa stinë, pa zogj, pa bar,  
As shkretëtirë ti nuk je,  
Sepse as heshtjen në Saharë,  
O tokë e dhimbjes, ti s'ë ke!

UDHA E MËMËDHEUT  
Poemë e Abdyl Frashërit

**— Poemë —**

Udhë e Memëdheut  
(Abdyl Frashërit)

1. Ku s'të hodhi jeta, dallgë e saj e ashpër,  
Po kudo që vajte zemrën le në Frashë.

Ku s'të hodhi jeta, dallgë e saj e ashpër,  
Po kudo që vajte zemrën le në Frashë.  
Jelekreshpëruar turfullonte kali,  
Mendimet si plumbë nëpër shteg të ballit...

Ç'ish kjo udhë e gjatë që po merrje ti,  
Ç'hall i madh të nisi ty për Rumeli?

**2.**

Që nga Anadolli po fryn erë e marrë,  
Shpresat dhe dëshirat rrafsh për të na tharë.

Po kur fund dō marrin këtol'helfme, dertë  
Këta lotë të hidhur nëpër vilajete?

Eh, kjo Shqipëria zien si kazan,  
Nuk është ujë që zien, po janë gjakrat tanë.

Ti, moj Portë e Lartë, për ne je e unjët,  
Me zor na arrin deri mu te gjunjët.

Kërkon që të ngrihesh përmbi malet tanë  
Dhe me fjalë e lajka, dhe me jatagan...

Dy duart e kombit, që të dyja zënë,  
Njëra-në martinë, tjetra-në parmandë.

**3.** Nëntor e shtatorit qendrën e kundërshtimit  
dëshironi që vrapojnë poç i madhi që do t'i bë  
Ecën deputeti me vendim të prerë,  
Ditën s'do të rrijë, natën s'do të flerë.

Eh, mendimet tutje vrapojnë si veri,  
Udhë e tyre zgjatet nëpër histori...

...Katër vjet dekretin nisi Portë e Lartë;  
E niste të plotë, i kthehej gjysmak.

Armët nuk i japim, s'e dorëzojmë lirinë,  
Me se do ta mbrojmë, pa armë, Shqipërinë?

Porta do nizamë, po nizamë nuk ka,  
S'ka të japë xhelepe vendi fukara.

**4.**  
Nuk pranon Gjakova, qëndron me guxim,  
Tirqe gjaku shfaqen mbi tirqet e zinj.

Shkupi i çon ndihmë qeta me bajrakë,  
Si vëlla e motër po përgjaken bashkë.

O halldupë, ku shkoni? Ka vetëm një shteg—  
Shtegu i Gjolekës me pesëqind dyfekë.

Dhentë s'na dhanë qumësht, dhentë s'na dhanë  
lesh,  
I thonë gur i thatë, i thonë Kurvelesh... .

Gjolekë «fermanliu» bredh kudo si erë,  
Kokën i kërkoka pasha serasqer.

Po a kapet era? A kapet veriu?  
Po aq' mënd të kapet Gjolekë «fermanliu»!

## 5.

Padishah, kërkojmë Arnautistan,  
Plakës Gjylhane gonxhet seç i ranë.

Ç'ke, moj plakë gërmuge, që s'po mbahesh dot,  
Sa shekuj ti ke, që po arron në botë?

Tani të erdhi fundi, vdisse zeza plakë,  
Mjaft më jataganin ngjeventi me gjak:

Kemi vënë duart, të gjithë në dyfek,  
Shqipëria s'njeh kartë e mëreqep<sup>1)</sup>.

6. Vendi i parë i mbretit, i cili i mbanë  
...Ajo dëshiron, se IX Tërkë, një përkohësi.  
Udhës drejt atdheut, kthehet deputeti,  
Natë e ditë ecën, pas Stambolli mbeti.

Kreshpërohen rrudhat, kreshpërohet kali,  
Mëndimet si krisma nëpër shteg të ballit...

Primë, o Isuf-qeni, primë, i ziù bëj,  
Që na ndolle qentë të ná vijnë këtej.

---

1) Bojë.

Job d'Mallakaster trime; ç'e paske një djalë,  
Isuf bej Vrionin na e zu të gjallë.

Më të lumtë, o Rrapo, palla që të ndrin,  
Ja hoqe xhahilit kokën mu në Sinjë.

Desh niżamë, xhelepe beu derdimen,  
Fshatafet në hu kokën ia kanë vënë.

I kanosen kokës, rrethuar me çallmë:  
— Hë, xhelepe deshe? Xhelepe të dhamë...

V.

— Lordi Bikonsfield, ti që je anglez,  
E di ç'do të thotë që shqiptar të jesh?

Ti thith puro zhytur në kolitukë Evrope,  
Ne imbathim këmbët me lëkurë lope...

Një lëkurë e mirë mjafton për një çetë,  
Tridhjetë palë opinga nxjerr për tridhjetë vetë.

Gjuha s'na mungoi, germat na munguan,  
Duam alfabetin, shkrimin tonë duam...

Erdhëm gjer këtu që nga «Evëtari»  
Buzëqesh i lumtur Naum Veqilharxhi.

8.  
Brinjë më brinjë qëlluar, me shpirtin te  
dhëmbët,  
Perandorinë-plakë nuk e mbanin këmbët.

Nga vevetja malet po gatitnin zjarrin,  
Urrejtjen e mbledhur ta shkrepnin si strallin.

Dhe i nisën bijtë, (fjalët-maliher!)  
Në Prizren të bënин besa-besën, prerë!

— Kurrë te sulltani nuk e zgjatëm dorën,  
Më ferman lirinë asnjeherë s'e morëm.

Në flamur shqiponjën s'e ndërruam me hënën,  
Sepse bukë dovleti asnjeherë nuk hëngrëm!

Kancelär Bismarku s'do ta dijë këtë,  
Gishtin shkon në hartë, na përgjak me të.

Që nga Dardanelet deri në Berlin,  
Telegramet venë, telegramet vijnë.

Dhëmbët «luaneshë» mprehënë Marmara,  
Dimrin e disfatës përmbi kokë e ka.

— Po s'na njohët ju, s'ju njohim as ne,  
S'njohim Shën-Stefan, as Berlin mbi dhë.

9.

Mark Milan Vojvoda seç po qan me lot,  
Rrugën ky vojvoda nuk po e gjen dot.

Mbetur pa flamur, s'di se nga të marrë,  
S'di se si të bëjë, mbetur pa ushtarë...

Kërcenojnë me vdekje lisat edhe kreshtat,  
Po u thyhen gjunjët, po u dridhen mjekrat.

II

Shtigjet veç ngushtohen, shtigjet marrin zjarr,  
Tetë mijë dyfekë zbrazen mbi ushtarë.

Plava dhe Gucia bien erë barot...

Mark Milan Vojvoda seç po qan me lot...

10.

Dhe me armë në krah, dhe me këngë në buzë,  
Na prit ti, o Hot, na prit ti, o Tuz...

S'jemi plaçkë tregu në pazar Ballkani,  
S'na blen dot Evropa, s'na shet dot sultani.

S'do të vini dorë kurrë te ky dhë,  
Sa të jetë i gjallë goftë dhe një nga ne!

Kemi zënë çdo shteg, kemi zënë çdo rrugë,  
Flakë pér flakë, o Hot! Flakë pér flakë, moj  
Grudë!

## 11.

Pse trazohet deti, pse po ngre kaq dallgë?  
Njëzet luftanije shfaqen atje larg...

Ç'do kjon flotë këtu, pse na rrri krekosur,  
Ne dhe pér një gur vdesim të vendosur.

Ah, flotë e mallkuar, na le pa Ulqinin,  
Dallgë-dallgë gjoksi na rrri zemërimin.

Deti kërkon brigje, zien, shkumëzon,  
Ku do ta përplasim zemërimin tonë?

**12.**

Ç'ka ky Ali Ibra lart në vraç të zi?  
Shtatë martina bashkë e kanë marrë në gjji.  
Ç'u thotë shokëve ky Ismail Hyseni?  
Ku më gurroi gjaku, gjakun të më merrni.

Sulejmani i Vokshit djemvë ç'u thërret?  
Qitni thikat, burra, po s'patët fishekë...  
Ç'bën ky Niman Sula, mbetur krejt pa këmbë?  
Vdekjen ha me sy, vdekjen ha me dhëmbë.

**13.**

Fshat më fshat kalove ditën edhe natën,  
Kasollja m'e varfër për ty dha kafshatën.

Nga Evropa plakë tutje në Azi,  
Nuk t'ë lodhi udha ty për Shqipëri.

Në hejbe ti mbaje plot «Alfabetare»,  
Shkronjat e Samiut, germëzat amtare...

Vjershat e Naimit plot ta mbushin xhepin,  
Prapë në udhëtim, prapë patkonjtë shkrepin...

Katër-pesë dyfeqe pritën ty ta zunë,  
Me një varg koshadhesh në Stamboll të shpunë.  
Ç'udhë të gjatë që bëre ti për Shqipëri,  
Gjurmët që le udhës janë në histori.

18

... qëndrojnë sot, qëndrojnë më i vjetra, qëndrojnë  
Lëvizja e së pashme, qëndrojnë sot, qëndrojnë më i vjetra,

## *PASQYRA E LËNDËS*

	Faqe
Monologu i agronomit .....	3
Nisje .....	4
Pjekuria dhe fëmijëria .....	5
Gjashtë ditë .....	6
Ngrohtësi .....	7
T'i shtypim në vezë .....	8
Era .....	11
Në vjeshtë .....	12
Pesha e duarve (poemë) .....	13
Copëza jete .....	28
Dasma e Skënderbeut .....	35
Gjin Bue Shpata .....	37
Çelën sythe e lule mollët .....	39
Arbëreshët .....	42
Bien daulle rrëzë malit .....	44
Nevada .....	48
Udha e mëmëdheut (poemë) .....	49

Ejupi, N.

Pesha e duarve. Vjersha  
dhe poema. T., «Naim Fra-  
shëri», 1980.

64 f.

(B. m.) dhe

(B. v.): 891.983-1

E 46

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re,  
Tiranë, 1980.